A K E P

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Qëndrimi i AKEP për komentet e dërguara gjatë Këshillimit Publik

Rregullore për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar

Adresa: Rr. "Abdi Toptani",
Godina Torre Drin, K. IX, Tiranë

Tel : ++ 355 4 2259 571
Fax : ++ 355 4 2259 106

www.akep.al
info@akep.al

Bazuar në Ligjin Nr.46, datë 7.5.2015 "Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2616, datë 10.09. 2015 "Për Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit "Rregullore për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar"", AKEP kreu një Këshillim Publik me palët e interesuara.

Procesi i keshillimit publik u zhvillua nga data 10.09.2015 deri në datën 20.10.2015.

Në përfundim të afatit të Këshillimit Publik janë administruar komentet e dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal "Operatori A", me shkresën nr.3209/1, datë 20.10.2015 "Mendime mbi dokumentin "Rregullore për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar"".

Më poshtë paraqiten komentet e Ofruesit të Sherbimit Universal "Operatori A" dhe qëndrimi i AKEP mbi këto komente.

"Operatori A" **- Komente**

Koment:

1. Neni 4 "Termat dhe përkufizimet" të formulohet si më poshtë vijon:

Adresa: çdo grup shenjash në një objekt postar që tregojnë marrësin dhe pikën e dorëzimit të objektit postar. Adresimi i **objekteve** postare do të rregullohet më hollësisht në termat dhe kushtet e përgjithshme të ofruesve të shërbimeve postare;

Qëndrimi i AKEP:

Bazuar në nenin 3 "Perkufizime" të ligjit 46/2015, AKEP merr në konsideratë sugjerimin sipërpërmendur, i cili do të pasqyrohet në Rregullore.

Koment:

2. Neni 7 "Karakteristikat e objekteve postare" pika 3 dhe 6 të formulohet si më poshtë:

2.1 Pika 3

Objektet e korrespondencës përmbajnë materiale të shkruara ose të shtypura, dhe pakot postare përmbajnë **mallra.**

Koment:

2.2 Pika 6

Adresa është informacioni që tregon qartë marrësin e objektit postar. Adresimi i objekteve postare do të thotë vendosja e adresës së marrësit në objektin postar. Në rast të objekteve postare

që kërkojnë **dokument** të pranimit, dërguesi duhet të vendosë adresën e tij/saj në objektin postar në mënyrë të tillë që të mos mund të fshihet pa lënë gjurmë të dukshme në objektin postar.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP, merr në konsideratë sugjerimin sipërpërmendur, ne saktesimin e termave, i cili do të pasqyrohet në Rregullore.

Koment:

3. Neni 8 "Përcaktimi i ofruesit të shërbimit universal", pika 2 të formulohet si më poshtë:

AKEP, cakton **ofruesin/ofruesit** e shërbimit universal postar, në bazë të një proçedure konkurrimi, sipas rregullave të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP, merr në konsideratë sugjerimin sipërpërmendur, ne saktesimin e termave, i cili do të pasqyrohet në Rregullore.

Koment:

4. Neni 9 "Kushtet për ofrimin e shërbimit universal" të formulohet si më poshtë:

Kushtet për ofrimin e shërbimit universal do të rregullohen në përputhje me:

a) Ligjin për shërbimet postare;
b) Rregulloren për ofrimin e shërbimit universal;
c) Termat dhe kushtet e përgjithshme të përgatitura nga ofruesi i shërbimit universal;
d) Aktet e Bashkimit Universal Postar për shërbimet universale në trafikun postar ndërkombëtar.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP, merr në konsideratë sugjerimin sipërpërmendur, në ndarjen me nenpika të përmbajtjes së tekstit të nenit 9, i cili do të pasqyrohet në Rregullore.

Koment:

5. Neni 10 "Të drejtat dhe detyrimet e ofruesit të shërbimit universal" pika 3 të formulohet si më poshtë:

Në rast të pamundësisë për të dorëzuar një objekt postar letër, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ofruesi i shërbimit universal, ofruesi i shërbimit universal duhet t'i **dërgojë** të

gjitha objektet postare pa pagesë në adresën e re të marrësit, nëse kjo njihet, ose ta kthejë atë tek dërguesi. Shërbimi i **dërgimit** tek adresa e re e marrësit për pakot postare apo për kthimin e tyre tek dërguesit do të tarifohet nga ofruesi i shërbimit universal në përputhje me tarifat e vlefshme për shërbimin postar.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP, merr në konsideratë sugjerimin sipërpërmendur, ne saktësimin e termave, i cili do të pasqyrohet në Rregullore.

Koment:

6. **Neni 13** "Zyre Postare" pika 8 të rimormulohet pasi është e paqartë në përkufizimin e dhënë.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP, merr në konsideratë sugjerimin sipërpërmendur, në riformulimin e pikës 8 të nenit 13, i cili do të pasqyrohet në Rregullore i riformuluar si më poshtë.

Pika 8 e nenit 13 - e riformuluar

Zyra postare doganore hapet nga ofruesi i shërbimit universal në bazë të një marrëveshje të lidhur me Administraten Doganore të Republikës së Shqipërisë.

Koment:

7. **Neni 15** "Kutia postare dhe kutia postare e përbashket" pika 4 të riformulohet është e paqartë, dhe të bashkohet me pikën 3, se e veçantë nuk ka sens me përkufizimin e këtij neni.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP, merr në konsideratë sugjerimin sipërpërmendur, ne riformulimin e pikes 4 te nenit 15 dhe bashkimin e pikes 4 ne piken 3, i cili do të pasqyrohet në Rregullore i riformuluar si me poshte.

Pika 3 e nenit 15 – e riformuluar në të cilën është përfshirë dhe pika 4.

Çdo kuti postare duhet të ketë të shënuar orën brenda së cilës objektet postare që duhet të shpërndahen brenda ditës, mund të pranohen apo të hidhen në këto kuti, në varësi të kategorisë së shpejtësisë së shpërndarjes. Objekti postar i kategorisë më të shpejtë duhet të hidhet në kutinë postare që ka të afishuar tarifat për shërbimet postare të kategorisë me të shpejtë.

Pika 5 e nenit 13 bëhet pika 4.

Koment:

8. Neni 17 "Dendësia e pikave të aksesit" pika 3 të ndryshojë si më poshtë:

Ofruesi i shërbimit universal është i detyruar të ndërtojë një rrjet të pikave të aksesit në zonat e banuara me distancë maksimale midis këtyre pikave mesatarisht prej 10.000 m.

Ky propozim vjen pasi objekti postar letër e thjeshtë në rang global botëror është drejt rënies, kështu vendosja e pikave të aksesit në distanca më të shkurtra përbëjnë kosto të panevojëshme, pasi nuk do të përdoren. Gjithësesi ky përcaktim kërkon një studim më real dhe vendimarrje të Ministrit.

Qëndrimi i AKEP:`

AKEP, në lidhje me komentin e dhënë nga Ofruesi i Shërbimit Universal për pikën 3 të nenit 17, gjykon se treguesit e caktuar në këtë nen do te saktesohen me percaktimet qe do te behen ne Urdherin e Ministrit mbi dendesine e pikave te aksesit dhe neni 17 reduktohet dhe riformulohet si me poshte:

Neni 17 "Dendësia e pikave të aksesit" – i riformuluar

Ofruesi i shërbimit universal është i detyruar t'a organizojë rrjetin e zyrave postare në mënyrë që të garantojë dendësine e pikave të aksesit të përcaktuar në urdhërin e ministrit, duke marrë në konsideratë nevojat e përdoruesve.

Koment:

9. Kreu VI - TARIFAT, KOSTOT NETO PER OFRIMIN E SHERBIMIT UNIVERSAL POSTAR DHE NDARJA E LLOGARIVE

Neni 20 pika 2 të formulohet si më poshtë;

AKEP-i ka të drejtë të zbatojë rregullimin e tarifave të shërbimit universal sipas përcaktimeve të Ligjit 46/2015.

Aplikimi i një tarife të njëjtë, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk e përjashton të drejtën e ofruesit të shërbimeve universale postare për të lidhur kontrata individuale për tarifa të reduktuara me përdoruesit, për pranimin e objekteve me shumicë, sasia e të cilave është jo më pak se 5000 objekte postare në muaj.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP, merr në konsideratë sugjerimin sipërpërmendur, i cili plotëson dhe saktëson përmbajtjen e pikës 2 të nenit 20, në të cilën i jepet e drejta ofruesit të shërbimit universal në aplikimin e tarifave të reduktuara për pranimin e objekteve postare me shumicë, i cili do të pasqyrohet në Rregullore.

Koment:

10. Neni 23 "Akses ndaj të dhënave të ofruesit të shërbimit universal" **pika 1, germa d** të formulohet si më poshtë:

Shërbimin **e dërgimit të objekteve** postare dhe shërbimin e kthimit të **objekteve** postare tek dërguesi.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP, merr në konsideratë sugjerimin sipërpërmendur, ne saktesimin e termave, i cili do të pasqyrohet në Rregullore.